

VENDIM
Nr.912, datë 26.8.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.857, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN, NË QYTETIN E PESHKOPISË, TË FILIALEVE DHE
TË PROGRAMEVE TË STUDIMEVE, TË FAKULTETEVE TË EKONOMISË E TË
ADMINISTRIMIT, TË EDUKIMIT DHE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE,
TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN
E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO
PROGRAME STUDIMI, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, 11, pika 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.857, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

- “3. Filiali i Fakultetit të Edukimit do të ofrojë programet e studimit, të ciklit të parë, në:
- a) Matematikë-Fizikë, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në matematikë-fizikë;
 - b) Matematikë-Informatikë, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në matematikë-informatikë;
 - c) Informatikë-Anglisht, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në informatikë-anglisht;
 - ç) Gjuhë-Letërsi-Anglisht, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në gjuhë-letërsi-anglisht;
 - d) Biologji-Kimi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në biologji-kimi;
 - dh) Psikologji-Sociologji, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në psikologji-sociologji;
 - e) Procese formimi, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në procese formimi”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha